ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

*****Shënim:** Për kryerjen e verifikimeve përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në shtojcën 7, lutemi të plotësoni të dhënat për personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

Emër, (1)	Atësi, (2)	Mëmësi, (3)	Mbiemër, (4)	Ditëlindje (5)	Nr. Personal i ID (6)
--------------	---------------	----------------	-----------------	-------------------	--------------------------

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);*
- Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;*
- Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;*
- Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*
- Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;*
- Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9 kriteret e përgjithshme të kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit financiarë nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

2.3 Për kapacitetin teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit, realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi.

- Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë kontrata/kontratat perkatëse të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj/te tyre ose fatura

tatimore të shitjes, ku te shprehen qarte datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

- Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë vetem faturat tatimore të shitjes, ku te shprehen qarte datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

b) Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjesve të siguruar për periudhën Janar 2019 – Shtator 2019 e shoqëruar me listepagesat (formularët E-sig 025 për këto periudha ku të ketë jo më pak se 5(pesë) punonjes.

c) Të vërtetojë që ka të paktën 1 (një) Inxhinier dhe 1(një) biolog/bioteknolog në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore i cili do të kryej trajnimet e stafit, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. |

ç) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal i përkthyer ose kopje e përkthyer dhe noterizuar.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë certificate CE ose deklaratë konformiteti për pajisjet e ofertuara, sipas direktivave përkatëse për MDD, në përputhje me klasifikimin e produktit.

dh) Ofertuesi duhet të paraqesë autodeklaratë për trajnimin e punonjesve që do të përdorin pajisjet mjekësore objekt prokurimi.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancisë për pajisjet, në të cilën duhet të saktësojë se periudha e garancisë të jetë jo më pak se 1 (një) vit, për çdo defekt të mundshëm teknologjik, sipas afatit të përcaktuar në specifikimet teknike. |

ë) Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofrohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). **Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes.** Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

f) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, dhe nëse operatori ekonomik ofertues është prodhues i pajisjeve mjekësore duhet të paraqesë çertifikatën **SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, për tregtim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e

Dokumentat Standarde të Tenderit

Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

g) Operatori ekonomik duhet të paraqese **oferten teknike**, per pajisjet objekt, ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut te pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Nr	Emertimi	Specifikime Teknike
----	----------	---------------------

Dokumentat Standarde të Tenderit

<p>1</p>	<p>Real Time Quantitative Thermal Block (RT - PCR)</p>	<p>Te kete pjate me kapacitet jo me te vogel se 95 poceta/0.2 ml. Te mundesoje ngrohjen dhe ftohjen me Peltier. Te kete vellim te mostres jo me te vogel se diapazoni 20 - 95 µl. Te kete diapazonin e temperatures jo me te vogel se 4 - 99°C. Te kete saktesi te temperatures jo me vogel se ± 0.5°C. Te kete temperature te Lid-it jo me te vogel se 90 - 110°C. Te kete te pakten dy porta USB me shpejtesi te larte. Rritja e temperatures te mund te behet jo me pak se 2°C/sekonde. Te realizoje ngrohje uniforme te bllokut. Te kete diapazon te rritjes se temperatures jo me te vogel se 0.1 - 2.0°C. Te shoqerohet me kompjuter me parametrat e kerkuara nga software i RT-PCR-se se ofruar. Te kete 5 sete filtrash emisioni/eksitimi. Te shoqerohet me printer lazer me ngjyra. Te kete burim drite llampe Short-arc (jo me pak se 120W). Te mundesoje ndricim uniform te termo-bllokut me teknologjine e ndricimit tunel. Te kete sensor 2D CCD jo me pak se 16 bit.</p>
<p>2</p>	<p>Mikroskop trinokular</p>	<p>Me kend ne intervalin 30° - 40°, distanca midis okulareve te jete e rregullueshme. Duhet te kete kete te pakten 4 objektive akromatik 4X, 10X, 40X, 100X. Duhet te kete fushe te levizshme lart- poshte; majtas - djathtas; para-mbrapa; Sistemi i fokusimit te kete rregullim te imet dhe rregullim te trashe. Te jete me ndricim LED dhe te kete intensitet te rregullueshem te drites optike. Te kete filter jeshil ose blu per driten. Te punoje ne rrjetin elektrik AC 220V 50 Hz Te kete kamera jo me te vogel se 9 MPixel.</p>

Dokumentat Standarde të Tenderit

3	Mikroskop binokular	<p>Me kend ne intervalin 30° - 40°, distanca midis okulareve te jete e rregullueshme.</p> <p>Duhet te kete kete te pakten 4 objektive akromatik 4X, 10X, 40X, 100X.</p> <p>Duhet te kete fushe te levizshme lart- poshte; majtas - djathtas; para-mbrapa;</p> <p>Sistemi i fokusimit te kete rregullim te imet dhe rregullim te trashe.</p> <p>Te jete me ndricim LED dhe te kete intensitet te rregullueshem te drites optike.</p> <p>Te kete filter jeshil ose blu per driten.</p> <p>Te punoje ne rrjetin elektrik AC 220V 50 Hz</p> <p>Te kete kamera jo me te vogel se 9 Mega Pixel.</p>
4	Frigorifer 2 - 12°C	<p>Frigorifer i pershtatshem per laborator</p> <p>Temperatura jo me pak se 2-12°C, me rregullim dixhital.</p> <p>Te kete dere me vete mbyllje prej xhami, me izolim dopio.</p> <p>Te mundesohet hapja e deres ne krahun e djathte ose te majte, sipas kerkeses.</p> <p>Te kete ndricim LED, kapaciteti jo me pak se 150 Litra dhe te mund te kycet.</p> <p>Te kete panel kontrolli me mikroprocesor.</p> <p>Te tregojne ne ekran: temperaturen, temperature e vendosur, daten dhe oren.</p> <p>Te kete alarme per: temperature te larte, te ulet, dera e hapur, efencen e kondensimit, demtim te sondes, mungese te energjise elektrike.</p> <p>Te kete funksion defrosting automatic.</p> <p>Te funksionojne me 220V/50Hz.</p> <p>Te kete strukture te jashtme prej celiku te galvanizuar dhe te jete i veshur me shtrese PVC.</p> <p>Struktura e brendshme te jete prej celiku te inoksuar.</p>

Dokumentat Standarde të Tenderit

5	Frigorifer ngrires	<p>Temperatura jo me pak se $-10^{\circ}\text{C} \sim -31^{\circ}\text{C}$. Te kete dere me vete mbyllje. Te mundesohet hapja e deres ne krahun e djathte ose te majte, sipas kerkeses. Te kete kapacitet jo me pak se 150 Litra. Te kete panel kontrolli me mikroprocesor Te tregojte ne ekran: temperaturen, temperature e vendosur, daten dhe oren. Te kete alarme zanore dhe vizuale per: temperature te larte, te ulet (nivelet e alarmit te jene te rregullueshme), dera e hapur, eficencen e kondensimit, demtim te sondes, mungese te energjise elektrike. Te kete funksion defrosting manual. Te funksionojte me 220~230 V/50Hz Te kete strukture te jashtme prej celiku te galvanizuar dhe te jete i veshur me shtrese PVC. Struktura e brendshme te jete prej celiku te inoksuar.</p>
6	Autoklave	<p>Me kapacitet jo me pak se 11 litra qe mund te kontrollohet nga presioni. Temperatura maksimale e sterilizimit jo me pak se 132°C. Presioni jo me pak se 2 bar.</p>
7	Mikrovale	<p>Te funksionojte me ngrohje dhe te kete jo me pak se 5 nivele fuqie. Te kete komandim mekanik dhe kapacitet jo me pak se 18 litra. Koha e ngrohjes te jete jo me pak se 55 min.</p>
8	Kape me flux laminar	<p>Te mundesoje mbrojtje te klases se I. Te jete me permasa pune jo me te vogla se 90 cm x 64 cm x 55 cm (W x H x D) dhe te mund te mbaje nje ngarkese jo me pak se 30 kg. Te kete intensitet te drites jo me pak se 1000 lux. Te kete shpejtesi te ajrit jo me te vogel se 0.4 m/s. Te kete parafilter dhe filter HEPA qe mund te nderrohen lehtesisht. Te kete dritare anesore me xham te temperuar dhe xhami perpara te jete i levizshem lart-posht. Te kete tavoline mbajtese prej celiku te inoksuar me lartesi te rregullueshme jo me pak se 75-95 cm. Te kete dezinfektim UV. Te kete panel kontrolli per te afishuar te dhenat.</p>

Dokumentat Standarde të Tenderit

9	Centrifuge	<p>Te kete jo me pak se 15000 rrotullime/minute. Te kete dy menyra te kontrollit te shpejtesise (rpm dhe rcf) si dhe shpejtesia te vendoset nepermjet tastieres se integruar. Saktësia e shpejtesise jo me pak se 1 rpm ose 1 x g. Te kete ndricim LCD dhe me ekran jo me pak se 48 cm2.. Te kete jo me pak se 5 programe te aksesueshem me butona direkte si dhe memorie per jo me pak se 95 programe. Te kete dy menyra per kontrollin e temperatures dhe diapazoni i kontrollit te jete nga -10°C deri +38°C. Te kete kontroll te kohes pas shpejtesise dhe fillimit me diapazon jo me pak se 95 ore. Te mundesoje heqjen e rrotorit pa patur nevojë për mjete dhe te mund ti vendosen disa rrotore. Rrotori te kete funksionin e auto-kycjes . Rrotori te jete me fibra karboni dhe me kapacitet jo me pak se 46 tuba 1.5 / 2 ml.</p>
10	Banjomari	<p>Kapaciteti jo me pak se 18 lt. Temperatura jo me pak se: temperature ambjenti +5°C deri ne 98°C. Stabiliteti jo me pak se ±0.5 °C . Veshja e brendshme te jete me material rezistent ndaj korrozionit. Te jete me temperature dhe kohe te rregullueshme. Te jete me rubinet shkarkimi. Te jete e pajisur me kapak.</p>
11	Polarimetër	<p>Polarimeter-P1000-LED, shkalla e ndarjes 1°, saktësia e leximit 0,05°, burimi i rrezatimit 1 LED me filtër, gjatësia e valës 589 nm. Polarimeter-P1000-LED, shkalla e ndarjes 1°, saktësia e leximit 0,05°, burimi i rrezatimit 1 LED me filtër, gjatësia e valës 589 nm. Shërben për matjen e këndit të rrotullimit optik dhe përcaktimin e përqëndrimit të lëndëve farmaceutike. Shërben për matjen e këndit të rrotullimit optik dhe përcaktimin e përqëndrimit të lëndëve farmaceutike.</p>

Dokumentat Standarde të Tenderit

12	Refraktometër Abbe	Analog Abbe refractometer AR4, intervali i matjes nD 1.3000 – 1.7200; 0-95 %Brix, saktësia e matjes nD ± 0.0002 ; ± 0.1 %Brix, rezolucioni nD 0.0005; 0.25 %Brix, prizmi matës – qelq optik, burimi i rrezatimit LED, gjatësia e valës 589 nm. Shërben për përcaktimin e treguesit të përthyerjes (indeksit të refraksionit) dhe përqëndrimit të sheqernave në format farmaceutike si shurube(anglisht: Cary 60 Instrument Bundle – G6860AA – includes Cary 60 and associated sundries, cell holder, WinUV software and Desktop PC)
13	Spektrofotometër FTIR	Specifikimet: Spektrofotometer Cary 60 UV-Vis, konfigurimi optik: double beam, gjatësia e valës 190 – 1100 nm, rezolucioni 1,5 nm, burimi i rrezatimit llampë ksenoni 80 Hz, shpejtësia e skanimit 24000 nm/min, përmasat 477 x 567 x 196 mm, pesha 18 kgSoftware kompatibël me spektrofotometrën e përshkruar më sipër (i instaluar), me kompjuter me desktop Software kompatibël me spektrofotometrën e përshkruar më sipër (i instaluar), me kompjuter me desktop (anglisht: Cary 60 Instrument Bundle – G6860AA – includes Cary 60 and associated sundries, cell holder, WinUV software and Desktop PC).
14	Franz Diffusion Cell	Specifikimet: Standart 25 MM Jacketed, me 6 fole, Semi-Automatike, e pajisur me qeliza difuzioni, mbajtës qelizash, përzierës magnetik prej çeliku (eviton korrozionin) i veshur me teflon, me tregues e kontrollues digital të shpejtësisë 200-800 rpm, ngrohës uji dhe sistem qarkullimi të ujit me sensor për nivelin e ujit që të mos dëmtohet nga ngrohja Shërben për prova depërtimi transdermal të përgatesave topike.
15	Aparat për zbërthimin e tabletave	aparati të ketë parametrat e Farmakopesë USP, BP. Aparati të ketë 2 pozicione për beker 1L në rezervuarin e ujit, sensor temperature në banjën e ujit, dhe kohe. Temp 25-40 grade, tensioni 230V 50HZ, sistemi i ngrohjes 300Ë 250V, rezervuari i ujit 8L, koha 1min deri 99 orë, 59 min, 59 sec, lëvizja 30 goditje në min.

Dokumentat Standarde të Tenderit

16	Aparat për matjen e thërmimit të tabletave	numri i tambureve 2, shpejtësia e rrotullimit 25 ± 1 rpm, saktësia ± 1 revolution, qartësia e matjes 1 revolution, range 0-999 revolutions, temperatura e funksionimit 10°C deri 50°C , fuqi $230\text{ V} \pm 10\%$, 50 Hz. Aksesorë IQ, OQ & PQ dokumente.
17	Mikroskop	Mikroskopë DM 1000 , me kamer HD për mikroskop me software WI-FI për PC dhe smartphohe dhe tablete (ICCWE) dhe softwarwe për aplikacion në tablet/smartphone.
18	Frigorifer te vegjel per zyre/ laborator	(Pa ngrirje)

19. Ekografi

Të jetë e përshtatshme për ekzaminimet abdominale, gjinekologjike, obstetrike, vaskulare, kardiake, pediatrike, muskuloskeletale, urologjike, ortopedike, cefalike, etj.

Të ketë përpunim dixhital për përfitim të imazheve me cilësi të lartë

Të ketë ekran me ngjyra, me teknologji LED dhe rezolucion minimal 1920×1080 pixel.

Madhësia e ekranit diagonal të jetë jo më pak se 21 inch. Këndi i shikimit vertical dhe horizontal të paktën 160° .

Pajisur me të paktën 4 porta për sonda të ndryshme konvekse, endokavitare dhe lineare.

Pajisja duhet të mundësojë funksionimin në multi-frekuenca ultrasonike. Të suportojë sondat me frekuenca në diapazonin minimal $1 \div 16$ MHz

Të ketë panel komandimi multi-funksional me tastjerë të ndricuar dhe butona të programueshëm.

Të ketë panelin e komandimit touch screen LCD, jo më të vogël se $13''$, me rezolucion 1920×1080 . Këndi i shikimit jo më pak se 75°

Modaliteti automatizuar për optimizimin e shkallës së dopplerit spektral, frekuencës dhe këndit të skanimit

Funksioni vendosjes së parametrave të skanimit optimale (në rast urgjence) të ketë rregullim.

Mundësi zmadhimi skanimit deri në min. 10-herë.

Thellësia e fushës së skanimit duhet të garantohet deri në 39 cm

Frekuenca e imazhit "frame rate" të jetë mbi 1400 fps

Ekografia të ketë diapazon të lartë dinamik mbi 280 decibel.

Të përfshihen të gjithë modalitetet e skanimit më poshtë:

2-Dimensional (2D)

Të ketë të mundësi selektimi për min. 5 shkalle frekuencash.

Gain jo më pak se 1- 250

Të ketë mundësi selektimi për 15 ose më shumë harta gri të ndryshme

Të ketë mundësi selektimi për të paktën 12 harta ngjyrosje

Të ketë focus të rregullueshëm jo më pak se 12 nivele

Color Doppler

Gain i rregullueshëm deri në 250

Densitet i linjës e rregullueshme të paktën 3 nivele

Frame rate jo më pak se 150fps.

Rregullimi i linjës bazë me të paktën 15 nivele dhe mundësiin version të ngjyrës.

PRF jo më pak se 1- 8 kHz

Harta e ngjyrave e rregullueshme jo më pak se 10

Filtri i murit i rregullueshëm të paktën 30-700

Power Doppler

Fuqia e rregullueshëm 0-100%

Filtri i murit i rregullueshëm 30-700

Mundësi selektimi deri në 8 ose më shumë harta ngjyrë për cdo sondë

Doppler Spektral PË

Të ketë mundësi selektimi për min. 5 shkalle frekuencash.

Shkalla e përsëritjes së pulseve: 1 deri në min. 15KHz

Gjatësia minimale e dritares së kampionimit 1 deri në 20mm

Korrigjimi i këndit jo më pak se 0-70°

Të ketë range dinamik me 5 nivele

Të ketë baseline të rregullueshëm me jo më pak se 15 nivele

Funksion automatik i dedektimit të spektrit dhe matjeve spektrale në kohë reale

Motion Mode

Të ketë Gain të rregullueshëm jo më pak se 1- 250

Të ketë mundësi selektimi për të paktën 5 shpejtesi skanimi

Të ketë opsion për paraqitje të imazhit në 3D

Të përfshihen Softëare të më poshtëm me licenca pa skadencë:

Paketa e plotë e matjeve Abdominale, gjinekologjike, obstetrike, vaskulare, kardiake, urologjike, pediatrike, pjesët e vogla,

Pakete e matjeve doppler automatike, në kohë reale.

Karakteristika të tjera:

Njësi memorie e integruar me kapacitet minimal 500GB.

Database i përfshirë për pacientët dhe imazhet.

Funksion raportimi me mundësi integrimi të imazheve, matjeve dhe grafikeve parametrike

Mundësi eksportimi i të dhënave në format BMP, JPEG (imazhe) dhe MPEG4 ose AVI (video).

Ndërfaqje: USB, HDMI, VGA, Ethernet (import/export të dhënash), Audio.

Furnizimi me energji: 220VAC/50Hz

Sonda dhe aksesore të përfshirë:

- Sondë ekonvekse me shkallë frekuence min. 1÷6 MHz
- Sondë lineare 2D me shkallë frekuencë min. 4÷16 MHz.
- Printer termik bardh e zi i integruar
- Pajisje DVD-RË e integruar për lexim-shkrim.

Specifikimet teknike

20. Lexues për shishet e hemokulturës

Të ketë jo më pak se 60 pozicione të mostrave.

Tëk etë inkubator në formë sirtari për mostrat.

Të ketë sistem për ngarkimin e mostrave me një hap.

Të ketë princip/teknologjia e përdorur: Kolorimetria

Të ketë sensitivitet / Ndjeshmëri më të vogël 1 se 10 CFU/ml

Të punojë me mostra: Gjak, CSF, lëngje peritoneale, lëngje pleurale, palcë kocke dhe lëngje të tjera trupi

Të ketë algoritmet llogaritëse bazë: 1. Akselerim I mbajtur; 2. Ritmi; 3. Pragu fillestar

Të suportoje shishet e hemokulturës: Aerobike, Pediatrike, Anaerobike, Aerobike, Pediatrikeme rezine, Anaerobike me rezine

Të jetë automatik, të ketë survejim dhe raportime të automatizuara; të ketë suportoje raporte negative pre-diagnostike

Të ketë raporte statistikore dhe të gjenerojë file në exel të përshtatshme për kërkim shkencor.

Të ketë system kontrolli të temperaturës: Sistem dysh nxehjeje (nxehje të ngurtë dhe nxehje me ajër)

Të ketë ekran me ngjyra jo më të vogël se 12 inch

Të ketë ndërfaqje komunikimi: USB, RS-232C, Lan

Të ketë kapacitet memorje jo më të vogël se 500GB

Furnizimi me energji elektrike: 100 deri 240V, 50/60Hz

21. Mulazh per urgjence

Mulazh adult modular me sistem te plote reanimimi. Mulazhi te kete mundesi praktikimi per CPR, infuzionin ne krah , matjen e presionit te gjakut ne krah, menaxhimin e frymemarrjes, defibrilim.

Te jete i perbere nga komponentet e meposhtem:

- Mulazh trupi i plote, me koke per menaxhimin e frymarrjes “Airway Larry”
- Krah i pershtatshem per infusione
- Krah per matjen e presionit te gjakut
- Aparat elektronik per kontrollin e presionit te gjakut
- Lekure kraharori per defibrilim
- Pompe spraj lubrifikuese
- Shiringe 3 cc me age
- Shirirnge 12 cc me age
- 2 cope qese serumi
- 3 klampe kapes
- 2 copa te vogla per fshirje
- Set infuzioni flutur
- Gjak sintetik
- Sfignomanometer
- Bateri

22. Mulazh per obsteri

Mulazh i Pelvisit me pjese anatomike te ndryshme. Mulazhi te lejoj studentet per te praktikuar ekzaminime te pelvisit. Gjitashtu te praktikojne procedura gjinekologjike dhe planifikimi familjar perfshire: palpimin abdominal; vendosjen dhe heqjen e spekulumeve; vendosjen dhe heqjen e kontraceptiveve Intrauterine. Ekzaminimeve bimanuale dhe reftrovaginale per:

Vlerësimi krahasues i madhësisë, formës dhe pozicionit të një uterine normale, të zmadhuar (shtatzënë) dhe fibroid; identifikimi i masës adnexale ose fekale; identifikimin e cerviksit normal apo abnormal (polyp ose karcinome)

Te jete i perbere nga komponenten e meposhtem:

- Mulazhi anatomic i Pelvisit- 1 cope
- Cerviks normal (per vendosjen dhe heqjen kontrceptiveve) – 1 cope
- Cerviks me karakteristika ektope – 1 cope
- Cerviks me polip endocervical – 1 cope
- Cerviks me karcinome – 1 cope
- Uterus normal – 1 cope
- Uterus me fetus 10 javesh – 1 cope
- Mase fekale – 1 cope
- Uterus me fibroid – 1 cope
- Mase adneksale – 2 cope

Te gjithe komponentet te kene mundesi fiksimi ne pelvis.

23. Dejonizues Destilator per prodhimin e ujit te paster (Pure Water System)

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall:		Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Real Time Quantitative Thermal Block (RT - PCR)	Cope	1
2	Mikroskop trinokular	Cope	1
3	Mikroskop binokular	Cope	2
4	Frigorifer 2 - 12°C	Cope	1
5	Frigorifer ngrires	Cope	1
6	Autoklave	Cope	1
7	Mikrovale	Cope	1
8	Kape me flux laminar	Cope	1
9	Centrifuge	Cope	1
10	Banjomari	Cope	1

Dokumentat Standarde të Tenderit

11	Ekografi	cope	1
12	Mulazh per urgjence	cope	2
13	Mulazh per obsteri	cope	3
14	Lexues shishe hemokulture	cope	1
15	Dejonizues/Destilator per prodhimin e ujit te paster (Pure Water System)	Cope	1
16	Polarimetër	Cope	1
17	Refraktometër Abbe	Cope	1
18	Spektrofotometër FTIR	copë	1
19	Franz Diffusion Cell	copë	1
20	Aparat për zbërthimin e tabletave	copë	1
21	Aparat për matjen e thërmimit të tabletave	cope	1

Dokumentat Standarde të Tenderit

22	Mikroskop	cope	5
23	Frigorifer te vegjel per zyre/ laborator(Pa ngrirje)	cope	4

Afatet e lëvrim: 60 ditë

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Dokumentat Standarde të Tenderit

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. __

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Mallrat – Tender i Hapur**

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
